

SHPALLJE PËR VEND TË LIRË PUNE

Në zbatim të ligjit nr.139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore” (i ndryshuar) njofton se në Inspektoriatin e Kontrollit dhe Mbrojtjes së Territorit pranë Bashkisë Elbasan shpall 1(një) vend të lirë pune në pozicionin :

➤ *Inspektor pranë Inspektoriatit të Mbrojtjes dhe Kontrollit të Territorit*

KREU I- Përshkrimi i përgjithshëm i vendit të punës

Inspektoriati i Kontrollit dhe Mbrojtjes së Territorit, pranë Bashkisë Elbasan, brenda territorit administrativ të Bashkisë Elbasan, ushtron përgjegjësinë e kontrollit të territorit dhe zbatimit të ligjshmërisë së standardeve teknike e kushteve zhvillimore në fushën e planifikimit dhe zhvillimit të territorit dhe të atyre të parashikuara shprehimisht në ligje të tjera.

Detyrat dhe Përgjegjësitë:

1. Verifikon përmbushjen e detyrimeve ligjore në fushën e planifikimit dhe zhvillimit të territorit;
2. Plotëson proces-verbalin e konstatimit dhe relacionin/mendimin sipas llojit të shkeljeve të dispozitave ligjore në fushën e planifikimit dhe zhvillimit të territorit;
3. Punon në vijimësi për përditësimin e informacionit mbi situatën ndërtimore si dhe njohjen e detajuar të kësaj situatë në shtrirjen gjeografike të territorit që mbulon.
4. Zbaton me përpikmëri grafikët dhe planet e punës së miratuar.
5. Përgjigjet drejtpërdrejt për zbatimin e ligjshmërisë dhe respektimin e etikës zyrtare dhe korrektesës në marrdhënie me subjektet që i nënshtrohen procedurave të kontrollit dhe inspektimit.
6. Përgjigjet drejtpërdrejt për zbatimin e ligjshmerisë, evidentimin dhe plotësimin korrekt të formularëve standart që dokumentojnë ushtrimin e përgjegjësiave procedurale të kontrollit dhe inspektimit.
7. Ndjek problematikën e paraqitur në shkresat dhe kërkesë-ankesat dhe informon me shkrim për problematikën e dala dhe jep mendim për zgjidhjen e tyre.
8. Paraqet relacionin për çdo procedure të mbajtur gjatë inspektimit.
9. Kontrollon zbatueshmërinë e lejeve të ndërtimit si specialist i fushës dhe pjesë e grupit të punës në IMT.
10. Jep mendimin e tij profesional – teknik në fushën e ndërtimit dhe është pjesë e plan veprimit të IMT-së për ekzekutimin e vendimeve të prishjeve sipas rasteve të nevojshme;
11. Kryen çdo detyrë të ngarkuar nga K/Inspektori.

KREU II – Kërkesa të përgjithshme për pranimin:

- Të jetë shtetas shqiptar;
- Të ketë zotësi të plotë për të vepruar;

- Të ketë përfunduar arsimin e lartë në fushat e inxhinierisë së ndërtimit, arkitekturës, urbanistikës, konstruksionit, transportit, teknologjisë së materialeve, gjeologjisë, hidrogjeologjisë në nivelin minimal të diplomës Master Shkencor
- Preferohet të ketë eksperiencë pune në fushën e ndërtimit ;
- Të ketë aftësi për të zbatuar përgjegjësitë dhe realizimin e objektivave të institucionit;
- Të mos jetë i dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e një krimi apo për kryerjen e një kundërvajtjeje penale me dashje;
- Të mos jetë dhënë ndaj tij/saj masa disiplinore e largimit nga puna.

KREU III-Dorëzimi i dokumenteve

Kandidati duhet të dorëzojë me postë apo drejtpërsëdrejti pranë Bashkisë Elbasan, brenda datës 04.08.2025.

1. Kërkesë me shkrim drejtuar institucionit të Bashkisë Elbasan;
2. Fotokopje e ID (kartë identiteti);
3. Jetëshkrim (CV);
4. Çertifikatë personale;
5. Çertifikatë familjare;
6. Një numër kontakti (e-mail) si dhe adresën e plotë të vendbanimit;
7. Diplomë dhe listë notash fotokopje;
8. Raport mjeko-ligjor për aftësi në punë;
9. Referencë me karakteristika specifike nga punëdhënësi ifundit (në rast punësimi të mëparshëm)
10. Vërtetim që nuk ka masë disiplinore në fuqi (në rast punësimi të mëparshëm);
11. Vërtetim nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor;
12. Vërtetim nga Prokuroria e Rrethit Gjyqësor;
13. Vërtetim i Gjendjes Gjyqësore (Dëshmi Penaliteti)
14. Fotokopje të librezës së punës (nëse ka);

Dokumentacioni i mësipërm të shoqërohet me listë e inventarizuar e dokumentacionit të dorëzuar, e nënshkruar nga kandidati.

Mungesa e njërit prej dokumenteve të mësipërme apo pavlefshmëria e tyre sjell skualifikimin e konkurrentit

Pas verifikimit paraprak të dokumentacionit, do të shpallet lista e kandidatëve të kualifikuar, në lidhje me dokumentacionin e paraqitur, si dhe data kur do të zhvillohet intervista me gojë.

Kandidatët e skualifikuar do të njoftohen nëpërmjet adresës elektronike për shkaqet e moskualifikimit.

Kreu IV – Mënyra e vlerësimit do të jetë:

Vlerësimi i dokumentacionit 40 pikë

Vlerësimi i intervistës me gojë 60 pikë

Në përfundim të procedurës së vlerësimit, kandidati që merr mbi 70 pikë në total do të shpallet kandidat i kualifikuar për plotësimin e vendit të lirë.

- Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë;
- Ligji nr 9780/2007, datë 16.07.2007 “Për inspektimin dhe mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e kundërligjshme” (i ndryshuar) dhe aktet nënligjore në zbatim të tij;
- Ligji nr.8402/1998, datë 10.09.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit” (i ndryshuar);
- Ligji nr.107/2014, date 31.07.2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit” (i ndryshuar);
- Ligji nr.9482, datë 03.04.2006 “Për legalizimin, urbanizimin dhe intergrimin e ndërtimeve pa leje” (i ndryshuar).
- VKM nr. 408 date 13.05.2015:Për miratimin e Rregullores së Zhvillimit të Territorit:”, I ndryshuar
- VKM nr. 894 datë 04.11.2015”Për unifikimin e kontrollit të territorit nga Inspektoriati Kombëtar I Mbrojtjes së Territorit dhe ai i Njësisë Vendore”
- VKM nr. 610 datë 22.09.2022”Për përcaktimin e rregullave të detajuara për mënyrën e caktimit të mbikqyrësit , detyrat dhe përgjegjësitë e tij, ku shtet dhe elementët e përgjithshëm të sigurimit përgjegjësisë profesionale, si rregullat procedurat dhe mënyrën e mbajtjes së dokumentacionit gjatë zhvillimit të punimeve”
- Udhëzimi nr. 2, date 13.05.2005”Për zbatimin e punimeve të ndërtimit”
- Udhëzimi nr. 3, date 15.02.2001”Për mbikqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit:, i ndryshuar

SHPALLJE PËR VENDE VAKANT NË SHËRBIMIN E MBROJTJES NGA ZJARRI DHE SHPËTIMI

Në zbatim të:

- Ligjit Nr. 152, datë 21.12.2015 “Për Shërbimin e Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimin” dhe aktet nënligjore në zbatim të tij;
- VKM Nr.520, datë 25.07.2019;

Bashkia Elbasan bën shpalljen e procedurës për pozicionin e lirë:

Shef parandalimi

**Afati për dorëzimin e dokumenteve është 10 (ditë) kalendarike nga dita e shpalljes:
04.08.2025**

1. KUSHTET DHE KRITERET

1. Kandidati për pozicionin “Shef parandalimi” duhet të plotësojë kriteret, si më poshtë vijon:

- 1.1. Të jetë shtetas shqiptar;
- 1.2. Të ketë përfunduar arsimin e lartë policor, ushtarak, juridik ose inxhinieri, niveli minimal i diplomës “Bachelor”, në degët inxhinieri, juridik;
- 1.3. Të jetë në gjendje të mirë shëndetësore dhe i/e aftë fizikisht për të kryer detyra me rrezik të shtuar;
- 1.4. Të mos jetë i përjashtuar nga shërbimi zjarrfikës, i Policisë së Shtetit apo nga institucione të tjera të administratës publike;
- 1.5. Të mos jetë i/e dënuar me vendim të forcës së prerë për kryerjen e një vepre penale.

1.2 DOKUMENTACIONI, MËNYRA DHE AFATI I DORËZIMIT

Aplikanti paraqet në njësinë e burimeve njerëzore dokumentacionin, si më poshtë vijon:

1. Formular aplikimi i cili tërhiqet pranë Shërbimit të Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimi;
2. Fotokopje e kartës së identitetit;
3. Dokument zyrtar që vërteton përfundimin e arsimit të mesëm ose të lartë;
4. Fotokopje të dëshmisë së aftësisë së drejtimit të automjetit të tipit “C”;

5. Fotokopje të dëshmisë së aftësisë së drejtimit të automjetit të tipit “D” për pozicionin “Drejtues automjetesh zjarrfikëse dhe shpëtimi”;
6. Çertifikatë e gjendjes gjyqësore;
7. Çertifikatë familjare;
8. Vërtetim nga gjykata;
9. Vërtetim nga prokuroria;
10. Raport mjeko-ligjor;
11. Dokument i lëshuar nga institucionet shëndetësore që vërteton se nuk është përdorues i lëndëve narkotike.

Dokumentet duhet të dorëzohen me postë apo drejtpërsëdrejti pranë Bashkisë Elbasan, brënda datës 04.08.2025.

1.3 REZULTATET PËR FAZËN E VERIFIKIMIT PARAPRAK

Në datën **11.08.2025**, Drejtoria e Administratës dhe Burimeve Njerëzore d të Bashkisë Elbasan, do të shpallë në faqen zyrtare të Agjencisë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive (portali “Shërbimi Kombëtar i Punësimit”), faqen zyrtare të bashkisë dhe në stendën e informimit të publikut, listën e kandidatëve që plotësojnë kushtet dhe kriteret e veçanta.

Në të njëjtën datë kandidatët që nuk i plotësojnë kushtet dhe kriteret e veçanta do të njoftohen individualisht nga drejtoria e burimeve njerëzore dhe shërbimeve mbështetëse, nëpërmjet adresës së tyre të e-mail-it, për shkaqet e moskualifikimit.

1.4 FUSHAT E NJOHURIVE, AFTËSITË DHE CILËSITË MBI TË CILAT DO TË ZHVILLOHET KONKURIMI

Kandidatët do të vlerësohen në lidhje me njohuritë mbi:

- a) Ligjin nr. 139/2015, datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar;
- b) Ligjin nr. 7961, datë 12.07.1995 “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë” i ndryshuar;
- c) Ligjin Nr. 152, datë 21.12.2015 “Për Shërbimin e Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimin” dhe aktet nënligjore në zbatim të tij;
- d) VKM Nr.520, datë 25.07.2019;
- e) Rregulloren për Shërbimin e Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimin.

1.5 MËNYRA E VLERËSIMIT TË KANDIDATËVE

Verifikimi paraprak i kandidatit, në lidhje me Dokumentacionin e dorëzuar:

1. Komisioni Përzgjedhës i përbërë nga struktura e MZSH-së në Bashkinë Elbasan dhe Sektori i Menaxhimit të Burimeve Njerëzore, shqyrton formularin e aplikimit, si dhe dokumentacionin e paraqitur nga aplikantët, për të verifikuar nëse ata plotësojnë kriteret e përgjithshme të përcaktuara në ligj dhe në rregullore.
2. Drejtoria e Administratës dhe Burimeve Njerëzore të Bashkisë Elbasan kërkon informacion nga strukturat vendore të Policisë së Shtetit për personalitetin e aplikantëve, për rekorde të mundshme kriminale.

3. Në përfundim të procesit të verifikimit hartohet lista emërore e aplikantëve që plotësojnë kriteret dhe çdo aplikant pajiset me një formular pranimit për testim, duke caktuar një numër kodik identifikimi, i cili vendoset në të gjithë formularët dhe dokumentacionin që përdoret deri në përfundim të procesit të pranimit.
4. Aplikanti që rezulton se nuk plotëson kriteret e përcaktuara në ligj dhe rregullore nuk kualifikohet. Drejtoria e Administratës dhe Burimeve Njerëzore në Bashkinë Elbasan njofton me shkrim aplikantin që nuk kualifikohet.
5. Aplikantët kanë të drejtën e ankimit te Kryetari i Bashkisë dhe pas mbarimit të afatit të ankimit mund t'i drejtohen gjykatës kompetente.

Në përfundim të procesit të verifikimit, kandidatët, të cilët plotësojnë kriteret e përcaktuara renditen në një listë sipas rendit alfabetik. Drejtoria e Administratës dhe Burimeve Njerëzore në Bashkinë Elbasan publikon listën e kandidatëve që kualifikohen për të konkurruar, datën, vendin dhe orën e saktë ku do të zhvillohet testimi me shkrim, testimi i aftësive fizike, intervista e strukturuar me gojë dhe testimi psikologjik. Publikimi bëhet në faqen zyrtare të Agjencisë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive (portali “Shërbimi Kombëtar i Punësimit”), në faqen zyrtare të bashkisë, median e shkruar lokale dhe në ambientet e brendshme të saj. Për të marrë këtë informacion, kandidatët duhet të vizitojnë në mënyrë të vazhdueshme faqen zyrtare të Agjencisë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive (portali “Shërbimi Kombëtar i Punësimit”) dhe faqen zyrtare të Bashkisë Elbasan, duke filluar nga data _____

Aplikanti që kualifikohet për të vazhduar procesin e pranimit në shërbimin e MZSH-së u nënshtrohet fazave të konkurrimit, sipas rendit të mëposhtëm:

- 1) Testim me shkrim;
- 2) Testim i aftësive fizike;
- 3) Intervistë me gojë
- 4) Testimi psikologjik;
- 5) Verifikim përfundimtar i aplikantit.

Në fazën e parë, kandidatët e kualifikuar do t'i nënshtrohen testimit me shkrim, i cili hartohet nga Drejtoria e Administratës dhe Burimeve Njerëzore të Bashkisë Elbasan në bashkëpunim me drejtuesin e shërbimit të MZSH-së. Testimi me shkrim shërben për të vlerësuar nëse aplikanti zotëron njohuritë dhe aftësitë e nevojshme për kryerjen e detyrave të punonjësit të shërbimit të MZSH-së. Testi me shkrim administrohet dhe vlerësohet me pikë nga komisioni i testimit. Në përfundim të testit me shkrim, sektori i Menaxhimit të Burimeve Njerëzore publikon zyrtarisht listën e renditjes së rezultateve të testit. Për aplikantët për nivelin e mesëm drejtues, testi me shkrim, përmban edhe njohuri mbi legjislacionin, veçanërisht mbi atë të shërbimit zjarrfikës. Rezultatet e testimit me shkrim dalin brenda së njëjtës ditë kur zhvillohet testimi. Aplikantët që kanë marrë 70% të pikëve të përcaktuara për testin me shkrim, njoftohen për të vazhduar procesin e testimit të aftësive fizike. Rezultatet e testit me shkrim ruhen në dosjen aplikantit dhe përbëjnë 50% të rezultatit të përgjithshëm të tij.

Aplikantët që nuk arrijnë 7% të pikëve të nevojshme të testimit me shkrim kanë të drejtë të riaplikojnë për t'u pranuar në shërbimin e MZSH-së, me shpalljen e radhës së vendeve të lira.

Në fazën e dytë, fituesit e fazës së parë do t'i nënshtrohen testimit të aftësive fizike, që teston aftësitë psiko-motore të aplikantit, ku përfshihen shpejtësia, shkathtësia fizike, rezistenca, forca

muskulare dhe koordinimi fizik, të domosdoshme për punën e punonjësit të shërbimit të MZSH-së.

Struktura e shërbimit vendor të MZSh-së duhet të sigurojë e të parapërgatisë kushtet për realizimin e testimit.

Testi i aftësive fizike vlerësohet sipas standartit të përcaktur në kohën e zhvillimit të testit.

Testi fizik përmban:

- a) Vlerësimin e peshës dhe të gjatësisë trupore, testin e vrapimit dhe testin e përgjithshëm të muskujve;
- b) Matjet fizike të gjatësisë dhe të peshës së aplikantit. Koeficienti i masës trupore është tregues që jep raportin e peshës së njeriut në kg pjesëtuar me dyfishin e gjatësisë trupore të tij (në metra);
- c) Testi i përgatitjes fizike përmban: kapërcimin e tarabolës, vrapim 2,400 metra dhe 300 metra, pompa për krahët (ulje-ngritje), si dhe ushtrime për muskujt e barkut (palosje).
- d) Vlerësimi për çdo komponent, sipas moshës dhe gjinisë bëhet sipas normave të përcaktuara në rregulloren e Shërbimit të MZSH-së Elbasan.

1. Rregullat dhe kriteret për kalimin e testit të aftësive fizike.

Rregullat dhe kriteret për kalimin e testit të aftësive fizike janë si më poshtë vijon:

- a) Aplikanti duhet të paraqitet në ditën e testimit me uniformë të rregullt sportive. Nuk janë të lejuara mjete, të cilat mund të krijojnë avantazhe gjatë testimit. Nuk lejohet gjithashtu, përveç rasteve kur specifikohet nga mjeku, veshja sportive, si: dorashka, rripa të trashë mesi, fashë elastike ose gjunjëza dhe varëse, të cilat mund të shkaktojnë dëmtim të individit gjatë testimit. Mjete elektronike, si: MP3 player, radio, telefona celulare apo bipera nuk janë të lejuara gjithashtu. Femrat duhet të heqin vathët gjatë zhvillimit të testimit, pasi kjo mund të shkaktojë dëmtim për ato.
- b) Vendi i testimit duhet të jetë i sheshtë e të mos ketë pengesa (të çdo lloji) që mund të ndikojë negativisht në formën sportive të aplikantit që testohet. Vendi i testimit duhet të përfshijë:
 - Vendndodhje që nuk krijon kërcënime fizike për të testuarit;
 - Një zonë të vçantë, ku mund të lexohen udhëzimet e testit, të quajtur “zonë parapërgatitore”.
 - Një sipërfaqe të butë, të sheshtë e të thatë për zhvillimin e disiplinave të pompave dhe palosjeve.
 - Një sipërfaqe të sheshtë e të qëndrueshme për testimin e vrapimit dhe me pjerrësi deri në 3%.
- c) Aplikanti duhet t’i kalojë të gjitha fazat e testimit fizik në rendin e kërkuar;
- d) Pikët maksimale të përcaktuara për këtë test janë 100 (njëqind). Aplikantët që kanë marrë mbi 60% të pikëve maksimale vazhdojnë procesin e testimit.

2. Pas përfundimit të testit, kandidatit i bëhet i ditur rezultati dhe, nëse ka kaluar, njoftohet për të vazhduar procesin e testimit.

Në fazën e tretë, fituesit e dy fazave të para do t’i nënshtrohen intervistës së strukturuar me gojë dhe testimit psikologjik.

1. Qëllimet e intervistës me gojë dhe testimit psikologjik, janë për të vlerësuar kandidatët në lidhje me:

- a) aftësitë e kandidatit për të menduar, analizuar, komunikuar dhe për të marrë vendime, sipas nivelit për të cilin aplikon;

- b) aftësitë e kandidatit për të reaguar në mënyrën e duhur në kushtet e një stresi minimal;
 - c) përshtatshmërinë e kandidatit për t'u bërë punonjës i shërbimit të MZSH-së.
2. Gjatë intervistës së strukturuar me gojë kandidatët do të vlerësohen në lidhje me aftësitë e kandidatit për të komunikuar qartë, për të shprehur ide dhe koncepte, si dhe për të analizuar e për të marrë vendime.
 3. Vlerësimi i intervistës përbën 50% të rezultatit të përgjithshëm të kandidatit.

Rezultati i përgjithshëm i aplikantit përcaktohet si shumatore e rezultatit të testit me shkrim 50% dhe rezultatit të intervistës me gojë 50%. Aplikantët renditen në listën përfundimtare sipas rezultateve të arritura. Kjo listë shpallet publikisht jo më vonë se të nesërmen e ditës së përfundimit të procesit të intervistimit me gojë.

Aplikanti skualifikohet në rastet e mëposhtme:

- a) Nuk kalon testimin me shkrim;
- b) Nuk kalon testin e aftësive fizike;
- c) Nuk kalon testin psikologjik;
- d) Ka deklaruar të dhëna të rreme apo ka paraqitur dokumente të falsifikuara;
- e) Rezulton përdorues droge apo ka varësi nga alkooli.

1.6

DATA E DALJES SË REZULTATEVE TË KONKURIMIT DHE MËNYRA E KOMUNIKIMIT

Në përfundim të procesit të konkurrimit, sektori i Menaxhimit të Burimeve Njerëzore publikon në Ëëbsite-in e Bashkisë Elbasan listen e rezultateve përfundimtare sipas rendit zbritës dhe fituesit që do të ndjekin procedurat e mëtejshme për pranim në shërbimin e MZSH-së.

1. Kandidati i kualifikuar për pranim në shërbimin e MZSH-së i nënshtrohet testimi fiziko-profesional dhe kursit përkatës pranë Akademisë së Sigurisë ose në qendra të trajnimit zjarrfikës.
2. Me përfundimin e kursit të trajnimit dhe të testimit përkatës, kandidatit për punonjës i nivelit bazë të MZSH-së i jepet grada ‘Asistent zjarrfikës’ dhe emërohet në detyrë me urdhër të drejtorit/shefit të shërbimit vendor të MZSH-së, ndërsa kandidatit për nivelin e mesëm i jepet grada “Inspektor zjarrfikës” dhe emërohet në detyrë nga drejtori i Përgjithshëm i MZSH-së, me propozimin e Kryetarit të Bashkisë

Për më tepër informacion për kushtet dhe mënyrën e zhvillimit të e konkurrimit, të interesuarit mund të referohen në Ligjin Nr. 152, datë 21.12.2015 “Për Shërbimin e Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimin” si VKM Nr.520, datë 25.07.2019.